



Për	Kryetarin e Komunës z.Bashkim Ramosaj
Nga	Drejtori i DBPZHR Rifat Stojkaj
Lënda	Raporti i Punës për vitin 2022
Datë	12/01/2023

PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës dhe aktiviteteve në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Deçanit që janë planifikuar periudhën Janar – Dhjetor 2022.

1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA – Listimi i aktiviteteve që janë planifikuar për periudhën vjetore janar – dhjetor 2022:

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2022
- Hapja e afatit për aplikim për grante komunale për fermerët Deçanas;
- Ndarja e mjeteve të punës për fermerët fitues të granteve komunale;
- Organizimi i takimeve dhe seminareve të ndryshëm me fermer;
- Hapja e kanaleve të ujitjes në gjithë territorin e komunës së Deçanit;
- Themeli i komisionit për njoftimin e fermerëve për procedurat e aplikimit për subvencione dhe grante;
- Përgatitja e stafit për afatin e aplikimeve për subvencione dhe grante;
- Hapja e sezonës së korrje shirjeve;
- Mbajtja e panairit të ushqimeve(produkteve) tradicionale;

- Përgatitja e raportit për fillimin e të mbjellave;
- Vizita në terren tek fermerët dhe tek fermerët përfitues të garantëve ;
- Themelimi i shoqatave të ndryshme
- Shpërndarja e mekanizmit bujqësorë për fermerët nga Komuna e Deçanit

2. AKTIVITETE E IMPLEMENTUARA – Listimi i aktiviteteve të implementuara gjatë periudhës raportuese nga DBPZHR:

- Është hartuar plani punës nga DBPZHR për vitin 2022;
- Është bërë përgatitja e planeve të ndryshme zhvillimore;
- Është hapur afati për aplikim në projektin “Mbështetje fermerëve nga Komuna e Deçanit me nga një Mëshqerrë barrëse Raca Hollshtajn”;
- Janë shpërndarë 15 palë Gërshërë për qethtarët tanë për qethjen e deleve;
- Janë shpërndarë 40 Spërkatëse;
- Janë shpërndarë 70 Motokultivatora;
- Janë shpërndarë 22 krerë mëshqerra barrëse për 22 fermer nga Komuna e Deçanit nga Kontingjenti i parë;
- Është përpiluar raport i veçantë për mbjelljet pranverore;
- Janë mbajtur punëtori dhe trajnime për fermerët prodhues të pemëve, perimeve dhe të Blegtorisë;
- Është përpiluar raporti dhe planifikimi për korrje – shirjet për vitin 2022;
- Është përcjellë rendimenti i kulturave pranverore;
- Është bërë përcjellja dhe raportimi i korrje – shirjeve;
- Janë ndihmuar fermerët me derivate gjatë korrje – shirjeve;
- Është ngritur komision i veçantë për informimin e fermerëve për aplikimet për subvencione – pagesave direkte për vitin 2022;
- Është hapur afati për aplikim për pagesa direkte nga MBPZHR;

- Është mbajtur “Panairi Veror i Produkteve” nga Deçani;
- Është hartuar plani vjetor për mbjelljet vjeshtore;
- Është bërë përcjellja e mbjelljeve vjeshtore;
- Është organizuar “Panairi i Ushqimeve Tradicionale dhe Dita e Gështenjës;
- Është përmbyllur me sukses “Afati për aplikim për subvencione – pagesave direkte”.
- Është bërë grumbullimi i të dhënave, rezultateve dhe prodhimtarisë bujqësore për 823 fermerë aplikues
- Janë kryer me sukses të gjitha procedurat për dhënien në menaxhim të Vend gjuetisë së Përbashkët “Lojza”;
- Është nënshkruar kontrata me shoqatën gjuetare “Agim Selmanaj” për dhënien në menaxhim të Vend gjuetisë së Përbashkët “Lojza”;
- Janë vizituar mbi 75 fermerë të ndryshëm gjatë gjithë vitit;
- Janë hapur dhe mirëmbajtur mbi 25 kanale të ujitjes në territorin e Komunës së Deçanit;
- Janë lëshuar 10 flete lëshime për prerje të masës drusore në pyje private;
- Janë organizuar mbi 30 trajnime të ndryshme në shërbim të fermerëve deçanasë;
- Është themeluar shoqata e pronarëve të pyjeve private.
- Janë shpërndarë 66 mëshqerra barrëse të racës Hollshtajn Frizis për fermerët nga Komuna e Deçanit nga kontingjenti i dytë (Donacion nga Komuna e Deçanit dhe OZHR Mëshqerra).

Ky raport është hartuar nga zyrtarët e DBPZHR- së dhe është miratuar nga Drejtori i DBPZHR z.Rifat Stojkaj

Deçan/Janar/2023

